



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 30.1.2026

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 10, datë 15.1.2026, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si më poshtë vijon:

➤ **DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE**
SEKTORI I PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE KOMBËTARE
SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

➤ **Detyrat kryesore:**

1. Kryen kontrollin dhe vlerësimin administrativ të dosjeve të aplikimit për skemat e mbështetjes kombëtare dhe dërgon për miratim tek përgjegjësi i sektorit, në zbatim të manualit të procedurave, udhëzimet përkatëse dhe legjislacionin e zbatueshëm.
2. Harton njoftimet me shkrim për aplikantët (sipas rastit) për vendimet që merren për aplikimin e tyre nga drejtoria.
3. Merr pjesë në hartimin e kontratave për aplikimet e pranueshme, si dhe amendime kur janë të pranueshme në zbatim të manualit të procedurave, udhëzimet përkatëse dhe legjislacionin e zbatueshëm.
4. Trajton kërkesat e deleguara nga përgjegjësi i sektorit të ardhura nga aplikantët/përfituesit për skemat e mbështetjes kombëtare.
5. Raporton tek përgjegjësi i sektorit dhe drejtori i drejtorisë mbi kryerjen e detyrave kryesore të përcaktuara.
6. Merr pjesë në hartimin dhe ndryshimin e manualeve të procedurave të drejtorisë sipas udhëzimeve të përgjegjësit të sektorit.
7. Identifikon dhe raporton parregullsitë/red flag e hasura gjatë procesit të punës në përputhje me manualet e procedurave.
8. Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori përkatës.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

- Diplomë e nivelit “Bachelor” në Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike, Shkenca Natyrore ose Shkenca Bujqësore. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
- Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Udhëzimin e Skemave të Mbështetjes Kombëtare.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 4.2.2026, ora 16:30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollështa”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL